

## **RUSIA, GJEORGJIA DHE DEMOKRACIA E TRADHËTUAR**

Sulmi i armatosur i Rusisë ndaj Gjeorgjisë fqinje, një vend sovran me një demokraci drejt konsolidimit, ngritja e marrëdhënieve midis NATO-s dhe Rusisë dhe kërcënimet për sigurinë që po shfaqen në horizont nga përpjekjet ruse për të krijuar vija të reja ndarëse në Evropë, nuk janë dicka e papritur. Ato janë rrjedhojë e zhvillimeve që pasuan dështimin e Rusisë në procesin e demokratizimit të vendit dhe e tradhëtisë që elitat e saj politike dhe ekonomike i bënë përpjekjeve të sapo nisura për një rend të ri demokratik në Rusi, menjëherë pas shpërbërjes së BRSS-së.

Elitat politike dhe ekonomike ruse besuan se jo demokracia, por zëvendësimi në politikën e jashtme i ideologjisë komuniste me nacionalizmi ekspansionist dhe jo zgjedhjet e lira, por burgosja e rivalëve politikë, shkelja e lirive e të drejtave të njeriut, censurimi i shtypit të lirë dhe shfrytëzimi i gazit dhe naftës për t'i bërë shantazh e presion fqinjëve, do ta ndihmonin më shpejt Rusinë që të kthehej në një superfuqi botërore. “Shtypja në Rusinë e Putinit është e shoqëruar me agresionin e tij jashtë vendit” do të deklaronte në muajin shkurt të këtij viti gjatë një seance në Kongresin Amerikan Eduart Lukas, gazetar veteran britanik, i cili për tre dekada ka mbuluar ngjarjet në Bashkimin Sovjetik dhe në Rusi, njëkohësisht autor i librit “Lufta Tjetër e Ftohtë: Si e kërcënon Kremli Rusinë dhe Perëndimin.”.

Nën presidencën e Putinin, ndonëse prodhimi i përgjithshëm kombëtar u rrit gjashtë herë, ka pasur një përkeqësim të të drejtave politike dhe humbje të mëdha të transparencës, lirisë dhe legjitimitetit, elementë që janë bazat e një shoqërie të qeverisur sipas ligjit. Në funksion të nacioanlizmit ekspansionist, rusët po përdorin edhe burimet e tyre energjitike. Në këtë fushë ata nuk duan të veprojnë sipas rregullave të ekonomisë së tregut, ku mallrat prodhohen dhe shiten, duke u bazuar në mënyrë strikte mbi bazën e fitimit. Ata duan dhe po i përdorin burimet e tyre energjitike për synime politike.

Rusët u përpoqën që të përdornin rastin e përcaktimit të statusit të Kosovës si momentin për t'u rikthyer si lojtarë kryesor në politikën ndërkombëtare, si dikur BRSS-ja. Por ata nuk luajtën mirë! Kërkuan t'i imponoheshin fuqive kryesore demokratike të botës. Dhe për këtë ata e përjashtuan veten nga vendimarrja. Kosova e fitoi pavarësinë dhe u njoh nga shtetet kryesore dhe më të fuqishme të botës. Rusët nuk duan ta pranojnë se në marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare, në shekullin ku po jetojmë, të qenit superfuqi nuk përcaktohet vetëm nga sasia e gazit apo e armëve që ka, por dhe nga aftësitë bashkëpunuese në çështjet e paqes e të sigurisë dhe përgjegjësitë që merr për to, nga fuqia e demokracisë dhe aftësia për të ndikuar nëpërmjet saj në prosperitetin e popujve.

Në përmbushje të qëllimeve të tyre për t'u rikthyer si lojtarë kryesorë në politikën ndërkombëtare, rusët kishin planifikuar edhe hapin tjetër, bile edhe hakmarrjen ndaj perëndimit në rast dështimi në Kosovë. Për këtë ata kishin kohë që flisnin për precedentin që gjoja mund të krijonte rasti i Kosovës, ndonëse e dinin se Kosova ishte një rast mjaft specifik, i pashembullt në llojin e saj.

Dhe objektivi ishte paracaktuar me kohë. Ishte Gjeorgjia, goditja e së cilës, sipas llogarive të rusëve, do të sillte disa përfitime njëkohësisht. Në rradhë të parë demokracia e saj dhe modeli i revolucionit të trendafiltë ishte kërcënim për interesat ruse. Gjeorgjia kishte brenda probleme nacionale të pazgjidhura. Ajo ishte aspirante për në NATO dhe naftësjellësi që kalon nëpër territorin e saj është një kërcënim për monopolin rus të furnizimit të perëndimit me naftë. Dikur portet e saj ishin vende të sigurta për flotën ruse të Detit të Zi. Plani i sulmit tashmë ishte në tavolinë i miratuar dhe gati për zbatim. Aventurizmi i presidentit Gjeorgjian Shakashvil vetëm sa i përshpejtoi dhe lehtësoi realizimin e planeve ruse.

Duke sulmuar ushtarakisht Gjeorgjinë rusët i treguan perëndimit se, nëse nuk përfillen, nuk do të hezitojnë të përdorin forcën ushtarake. I treguan fqinjëve se nuk do të hezitojnë të vrasin përpjekjet e tyre për ndërtimin e një demokracie perëndimore. Paralajmëruan NATO-n për të mos u zgjeruar më tej pranë kufijve rus. Kërcënuan në mënyrë të vecantë Ukrainën që po aspirojnë për në NATO. Paralajmëruan vendet e BE-së se nuk mund të shpëtojnë nga monopoli rus i furnizimit me energji. Gjithashtu Putini tentoi të përmbyste Shakashvilin, udhëheqësin e revolucionit të trendafiltë, i cili e kishte sfiduar më parë dhe i hapi mjaft probleme gjatë presidencës së tij. Plani në përgjithësi funksionoi.

Por zhvillimet deri në sulmin rus ndaj Gjeorgjisë janë përgjegjësi edhe e Perëndimit. E heshtjes së tyre ndaj mbytjes së demokracisë, mungesës së zgjedhjeve të lira e shkeljes së vazhdueshme të drejtave dhe lirive njeriut e të opozitës në Rusi. Ajo është rrjedhojë e mbështetjes nga perëndimi të zhvillimit të ekonomisë ruse, në dispropocion me përkushtimin e Ruisë ndaj vlerave demokratike. “Xhorxh Bush por edhe evropianët, kanë parë të heshtur mënyrën se si Putin, Presidenti i kthyer në Kryeministër, censuronte shtypin e lirë, burgoste rivalët politikë dhe shfrytëzonte pasuritë e Ruisë me gaz dhe naftë për t’i bërë shantazh e presion fqinjëve”, do të komentonte ditë me parë gazeta “The New York Times”, në artikullin e titulluar “Ftohja e re botërore”.

Duket se sulmi ushtarak ndaj Gjeorgjisë solli dhe disa “te mira” edhe për NATO-n. Pas tij u lehtësuan dhe përfunduan me sukses bisedimet për vendosjen e sistemit antiraketë në Poloni. Pas ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes me Poloninë, në kulmin e krizës, me datë 20 Gusht në Varshavë, Sekretarja e Shtetit Kondoliza Rajs dhe ministri i jashtëm polak, Radek Sikorski deklaruan se “negociatat ishin herë-herë të vështira, por rezultati ishte i kënaqshëm”. Për ironi të rusëve, edhe Ukraina tashmë ka bërë kërkesë për përfshirjen në sistemin evropian të mbrojtjes antiraketore. Gjithashtu sulmi ushtarak “shkundi” edhe disa shtete, me lidhje të reja apo tradicionale me Rusinë dhe që besonin akoma se ajo kishte ndryshuar, shtete të cilat po bënin rezistencë për zgjerimin e NATO-s drejt lindjes. Së fundmi, në këtë ftohje të re botërore që po përvijohet në horizont dhe që përkon me zgjedhjet e reja në Amerikë, ka mundësi të sjellë më shumë vota për Mc Cain, kandidatin republikan për president, ekspert për çështjet ushtarake.

Përfundimisht, dështimi i Ruisë në procesin e demokratizimit që në fillimet e tij, heshtja e Perëndimit ndaj shkeljeve të lirive atje, zëvendësimi prej rusëve i ideologjisë komuniste me nacionalizmin ekspansionit, do të çonte pa tjetër në një përplasje të tyre me botën

demokratike dhe me fqinjët që aspirojnë demokracinë perëndimore. Gjeorgjia është fillimi. Tashmë siguria në Evropë dhe më gjërë, nuk është më si më parë.

Xhavit Shala

[www.acnss.com](http://www.acnss.com)

Botuar në Gazetën “Shqip”, datë 26 Gusht 2008.